



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:012297

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06746962

PAKR.nr.622/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.Xh nga Prishtina, Rr.Sali Butka”, nr.31, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, dhe veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.27/2021, i datës 20.09.2024, në seancën e kolegjit me datë 11.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërishtë e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.27/2021, i datës 20.09.2024, vetëm sa i përket veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar dhe për këtë pjesë çështja penale kthehet në rigjykim dhe vendosje.

II. Refuzohet e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi, ndërsa vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.27/2021, i datës 20.09.2024, në pikën II. të dispozitivit të tij, për veprën penale, Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shqiptuar dënim me burgim prej një (1) viti dhe gjobë prej pesëqind (500) euro.

III. Pjesa tjetër e aktgjykimit që ka të bëjë me pikën II. të dispozitivit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.27/2021, të datës 20.09.2024, të akuzuarin J.Xh e ka shpallur fajtor për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 2 të KPRK-së, dhe veprën penale, Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në vijim: për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me dënim më gjobë njëmijë e pesëqind (1500) euro, dhe për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, më dënim me burgim prej një (1) viti dhe gjobë prej pesëqind (500) euro. Konform nenit 76 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i ka shqiptua dënim unik me burgim prej një (1) vit, dënim të cilin i akuzuari do të fillon ta mbajnë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim më gjobë prej dymijë (2000) euro.

I akuzuari është obliguar që dënimin e shqiptuar me gjobë t'a paguajnë jo më larg se tre (3) muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, dhe kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, si dhe nenit 365 par.3 të KPRK-së ka urdhëruara konfiskimin e përhershëm të sendeve të sekuestruara sipas vërtetimeve mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me nr. te rastit 2020-AB-0157, të datës 18.0.2024 dhe 19.01.2020 si në vijim: Substance narkotike e llojit m.. me peshë 1.6 gramë; Një pako rizilla; Substancë narkotike e llojit m...me peshë prej 7.87 gramë; Një qese me substancë narkotike e llojit heroinë me peshë prej 1.99 gramë; Një mulli per blurje; Një sprej me mbishkrim “Kxx”.

Gjykata ka urdhëruar Policinë e Kosovës- DKKO/DHTN në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin (asgjësimin) e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike të konfiskuar (substance narkotike e llojit m.. me peshë të përgjithshme 9.47 gram dhe të llojit h.... me peshë prej 1.99 gramë), e që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2020-AB-0157.

Gjykata ka urdhëruar që katër thikat multifunkionale (brisque të përbëra edhe nga veglat tjera si lugë, pirun, kaçavidë etj) dhe një thikë (brisk) pronë e të akuzuarit, të cilat janë sekuestruar sipas vërtetimeve mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me nr. të rastit 2020-xxxx, të datës 18.0.2024, t’i kthehen të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50) euro si dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në shumë prej pesëdhjetë (50) euro ashtu që në tërësi shumë prej njëqind (100 €) euro, është obliguar të paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarin t’a liroj nga aktakuza për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 2 të KPRK-së, sepse nuk është vërtetuar se ka kryer këtë veprë penale për të cilën është shpallë fajtor, ose aktgjykimin e ankimuar për kete veprë penale, t’a anuloj dhe çështjen t’a kthej në rigjykim, ndërsa për pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit që ka të bëjë me veprën penale, Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave

psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, t'a ndryshoj ashtu që dënimi i shqiptuar t'i zbutët.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim, PPA/I.nr.563/2024, të datës 28.10.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.27/2021, i datës 20.09.2024, të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantoi i akuzuari J.Xh dhe mbrojtësi i tij av. Selman Bogiqi, ndërsa nuk prezantoi Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tij. Mbrojtësi i të akuzuarit, J.Xh, av. Selman Bogiqi pasi që elaboroi pretendimet ankimore mbështeti propozimin e parashtruar në ankesë. I akuzuari J.Xhdeklaroj se e mbështet mbrojtësin e tij në tërësi.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit

Mbrojtësi i të akuzuarit J.Xh, av. Selman Bogiqi, në ankesë pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën I. të tij është i pakuptueshëm dhe kundërthënës lidhur me përshkrimin e veprës inkriminuese të të akuzuarit, e që është në kundërshtim me nenin 2 të KPRK-së, parimin e ligjshmërisë pasi që gjykata nuk e ka përshkruar në mënyrë të qartë dhe të saktë veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, nuk ka përshkruar se cilat veprime i ka ndërmarr i akuzuari. Pika I. e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin e tij ngase qartë vërtetohet se thikat (brisqet e gjetur) nuk përbëjnë vepër penale. Gjykata në mënyrë të gabuar ka vërtetuar faktin në faqen 9 të aktgjykimit se gjatë bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit me dt.18.01.2020 është gjetur edhe një sprej dhe është konfiskuar. Gjykata nuk e ka administruar si provë raportin për kqyrjen e vendit të ngjarjes, dosja e hetimeve 2020 xxx e përpiluar nga njësia e forenzikës Drejtoria Rajonale e Policisë e dt.19.01.2020, se në shtëpinë e të akuzuarit, në rrugën

“Sali Botka”, në Prishtinë është gjetur spreji i tipit KOFAG, e që nga kjo provë vërtetohet se spreji është gjetur në korridorin e shtëpisë pronar i së cilës është Ismet Xhakija, fq.nr. 2 e raportit, e që spreji nuk është gjetur në trupin e të pandehurit, as në veturë e as në dhomën ku ai banon. Ndërsa lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit mbrojtja ka thekësuar se i mbrojturi i tij në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ka përdorur substancën narkotike marihuanë dhe heroinë për 20 vite, ndërsa tani është duke u shëruar, duke marrë terapi të përshkruar si në raportet mjekësore të dt. 08.09.2022 dhe 11.09.2024, raporte që konstatojnë se i njëjti ka përdorur drogë të tipit heroinë dhe marihuanë dhe që ka qenë i varur nga këto substanca që nga viti 2005. Se gjykata gjatë dënimit unik nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose lirimin që është paraparë nën nenin 71 par.1 të KPRK-së, dhe e njëjta nuk i ka cekur kufijtë e zbutjes së dënimit siç parashihet në par.1.5 të nenit 72 të KPRK-së, ngase të akuzuarit do t’i shqiptohej një dënim shumë më i butë. Gjykata është dashtë të merr si rrethana lehtësues dispozitat e nenit 70 të KPRK-së. Se pranimi i fajësisë i bërë në mënyrë vullnetare është rrethanë lehtësuese, dhe gjykata është dashtë të aplikoj dispozitat e nenit 72 pika 1 dhe 5 të KPRK-së. Ka shtuar se gjykata duhet të ketë në konsideratë se i mbrojturi i tij ka shprehur keqardhje, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të ndërmerre asnjë veprim inkriminues në drejtim të kryerjes se veprës penale, është i gjendjes së varfër, andaj vuajtja e dënimit me burg do të ketë efekt negativ në jetën e tij. Nga e cekura ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësit të akuzuarit për shkelje esenciale lidhur me pikën I. të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar qëndrojnë, ekzistimi i të cilave kushtëzojnë anulimin e aktgjyqimit të ankimuar në pjesët që konstatohen këto shkelje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i ankimuar sa i për ket pikës I. të dispozitivit të tij që ka të bëjë me veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar.2.7, lidhur me neni 369 par.7 të KPPK-së, për faktin se dispozitivi i aktgjyqimit të ankimuar për këtë pikë është i pakuptueshëm dhe kundërthënës sa i përket përshkrimit të veprimeve inkriminuese të akuzuarit J.Xh. Nga përshkrimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë nuk mund të kuptohet se cilat veprime i ka ndërmarrë i akuzuari, nga se gjykata e shkallës së parë nuk ka përkufizuar në mënyrë të qartë

dhe të saktë veprën penale nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Kështu gjykata shkallës së parë në përshkrim të veprimeve të akuzuarit në dispozitiv përmend se nga i njëjti janë gjetur dhe konfiskuar pesë thika, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit thekëson se të njëjtat nuk mund të konsiderohen armë.

Në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar thuhet "se më datë 18.01.2020, rreth orës 20:20, njësitë policore të Stacionit Policor Qendra në Prishtinë, në rrugën "Halil Adlidemaj" në Prishtinë, kanë ndaluar veturën e tipit xxx, ngjyrë hiri, me targa xxx, të cilën e drejtonte i akuzuari J.Xh, tek i cili gjatë kontrollës në trupin e tij, është gjetur një thikë, ndërsa gjatë kontrollit të veturës, i janë gjetur 5 thika (briska), një kapelë e zezë e hapur tek sytë, një palë dorëza të zeza dhe pesë palë dorëza medicinale, si dhe gjatë kontrollës në shtëpinë e tij, me datën 19.01.2020 është gjetur edhe një sprej me mbishkrim *Kofog*, posedim që është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët".

Ndërsa në relacion me këtë çështje, në faqen 9, paragrafit 3 të aktgjykimit të ankimuar, gjykata ka konstatuar se: "Nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve, të dt.18.01.2020, me nr. të rastit 2020-xxxx, rezulton se katër thikat multifunkionale (*brisqe të përbëra edhe nga veglat tjera si luge, pirun, kaçavidë etj*) dhe një thikë (brisk) janë konfiskuar në automjet, e jo në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme prandaj të njëjtat nuk mund të konsiderohen armë".

Sipas Kolegjit, një përshkrim i tillë rezulton të jetë abstrakt, i pa konkretizuar, nuk përkufizohet në mënyrë të qartë dhe të saktë se cilat janë veprimet që i ka ndërmarr i akuzuari me rastin e kryerjes se veprës penale, se cilat janë armët që i akuzuari i ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët nga neni 366 par. 1 të KPRK-së. Prandaj mungesa e të dhënave konkrete e bënë dispozitivin e paqartë, pasi nuk përcaktohet qartë dhe saktësisht korniza e fakteve inkriminuese që duhet të provohen. Kolegji vlerëson se një mënyrë e tillë e ndërtimit të dispozitivit të akuzës, dhe më pas e bartur në aktgjykim në formë narrative, pa të dhëna, përmbajtje konkrete e specifike është e paqëndrueshme, nuk përkon me kërkesat ligjore që duhet ti përmbaj një aktakuzë dhe një dispozitiv i aktgjykimit, që nënkupton patjetër përshkrim të duhur të fakteve kryesore, rrethanave të rëndësishme dhe që korrespondojnë me tipare të veprës së caktuar penale.

Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me vendimin mbi dënimin për pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimur për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit për dënim me të butë për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, nuk janë të bazuara.

Gjykata shkallës së parë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit mbështetur në rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit mori në konsideratë: minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale, qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në kapitullin III të KPRK-se, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. Referuar nenit 69 par.1 të KPRK-së, gjykata shkallës së parë ka marr në konsideratë minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, *(për të cilën veprë parashihet dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet)*, andaj në rastin konkret gjykata të akuzuarit, për këtë veprë penale i ka shqiptuar dënim me gjobë pesëqind (500) euro dhe me burgim prej një (1) viti. Gjykata ka marr në konsideratë qëllimin e dënimit: *Të parandalojë kryesin që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij; 2) Të parandalojë personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale; 3) Të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe 4) Të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit* dhe në këtë rast, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, i përgjigjet realizimit të qëllimit, të parapare me nenin 38 të KPRK-së. Pra, gjykata mori në konsideratë rrezikshmërinë dhe pasojat, për faktin se substancat narkotike atakojnë drejtpërdrejt shëndetin e personave që konsumojnë atë, andaj dhe ka vlerësuar se një dënim i tillë do t'i parandalojë personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre.

Me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit, të shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjykata në pajtim me rregullat e përgjithshme për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke mos u kufizuar vetëm në rrethanat e parapara me nenin 70 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese konform nenit 70 par.3 të KPRK-së, gjykata mori në konsideratë rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit. Nga të dhënat me të cilat disponon gjykata, rezulton se i akuzuari ka pranuar fajësinë se ka blere substanca

narkotike per përdorim personal ngase ka qene përdorues i të njëjtave per njëzet (20) vite, dhe ka marr trajtim mjekësor dhe për këtë ka shprehur pendim. I akuzuari ka pranuar veprimet inkriminuese dhe ka shprehur keqardhje ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, në baze të të dhënave qe posedon gjykata, nuk ka gjetur asnjë rrethane rënduese.

Një vlerësim të tillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajesinë, ka shprehur keqardhje, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të ndërmerre asnjë veprim inkriminues në drejtim të kryerjes se veprës penale, është i gjendjes së varfër, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nuk janë të asaj natyre dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim tjetër nga ai që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës se parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Përfundimi: Kolegji arriti në përfundimin se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të shpjeguara në këtë aktgjykim, në raport me të akuzuarin për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilat shkelje gjykata e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje duhet ti evitoj. Ndërsa për pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar kolegji e refuzoj ankesën e mbrojtësit të akuzuarit dhe vërtetoj aktgjykimin në këtë pjesë.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 dhe 402 të KPPK-së, është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.622/2024, datë 11.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Mentor Bajraktari

Anëtarët e kolegjit:

Afërdita Bytyçi

Valbona Musliu Selimaj